



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 205/4 Prot.

Tiranë, më 27/ 4 /2018

V E N D I M

Nr. 113 , Datë 27 / 4 /2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 18, datë 06.02.2018, të paraqitur nga subjekti ankues M.R, kundër P.P¹ dhe V.G, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”². Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, dhe deklaratës së bërë pranë specialistes së Komisionerit në Korçë në datë 15.02.2018, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se në Tetor 2017 është paraqitur tek mjeku i familjes për të përfituar mjekimin me rimbursim për barnat: Plavix dhe Ranexa, dhe mjeku P.P i ka hedhur kartelën dhe e ka ofenduar duke i thënë “evgjit” dhe për sa kohë të ishte ai aty nuk do përfitonte barnat.

Në ankesë, M.R shpjegon se është operuar tri herë nga zemra dhe për herë të fundit nga data 21.08.2017 deri më 28.08.2017 ka qenë e shtruar në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe në bazë të diagnozës së paraqitur e cila është marrë nga mjekët specialistë të Tiranës dhe Korçës, duhet të përfitojë mjekimin falas për një periudhë 12 mujore për barin Plavix (clopidogrel), pasi gjendja e saj ishte kritike.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e barnave në bazë të ligjit nga mjeku i familjes.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

¹ P.P dhe V.G në cilësinë si, mjek të familjes, pranë Qendrës Shëndetësore Nr. 3, Korçë.

² M.R i përket komunitetit egjiptian të qytetit të Korçës.

Diskriminimi për shkak të racës është shkak i mbrojtur nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221/04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr.251, datë 13.02.2018 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjekteve, P.P dhe V.G, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga M.R.

Palët e interesuara kanë marrë dijeni për shkresën me anë të: Lajmërim marrje poste nr. RR 263897956 AA, RR 263898072 AA dhe RR 263898090 AA datë 14.02.2018 dhe nuk kanë kthyer përgjigje.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 66, datë 03.04.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit në Qendrën Shëndetësore nr.3, Korçë”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë Qendrës Shëndetësore nr.3, Korçë më datë 11.04.2018, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit, inspektorët e KMD-s, morën takim me P.P, me detyrë mjek familje dhe Drejtor i Qendrës Shëndetësore dhe V.G me detyrë mjek familje.

Gjatë inspektimit P.P informoi se: “Gjatë gjithë muajit Shtator 2017 ka qenë me leje vjetore dhe nga data 04.10.2017 deri më datë 14.12.2017³ i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për arsye të mbushjes së moshës së pensionit dhe në datë 16.12.2017 për nevoja të qendrës shëndetësore ka rifilluar punën si mjek familjeje. Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2017, M.R është ndjekur nga mjekja Y.Ç e cila ka trajtuar pacienten sipas skemës së spitalit. Në datë 27.12.2017, mjeku P.P ka vizituar, M.R dhe i ka dhënë mjekimin sipas rekomandimit të mjekur specialist nga Tirana. M.R është paraqitur përsëri në datë 26.01.2018 dhe ka marrë të njëjtin mjekim si në muajin dhjetor. Mjeku shprehet se me pacienten nuk ka patur asnjëherë debate apo të ketë përdorur gjuhë fyese, madje pacientja vazhdon vizitat pranë P.P si mjek familje. Nga pacientja ka patur kërkesë për ti

³ Referuar Vertetimit nr.50, datë 27.03.2018 të lëshuar nga Qendra Shëndetësore Rajoni nr.3, Korçë.

dhënë barin Plavix, por ky bar nuk rimburohet 100% dhe mjeku i familjes është i detyruar që të rekomandojë alternativën e parë sipas listës së barnave”.

Gjatë inspektimit V.G informoi se: *“Takimi i vetëm me M.R ka qenë në muajin Shtator 2017 në mjediset e qendrës shëndetësore, për ta ndihmuar dhe i ka shpjeguar kartelën e daljes nga spitali, por si mjek nuk ka të drejtë që ti japë recetë sepse pacientja ndiqej nga një mjek tjetër”.*

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Në pikën 1 të Urdhrit nr. 28, datë 26.01.2016 *“Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”* përcaktohet se: *“Çdo person që ka nevojë të marrë shërbim në institucionet shëndetësore publike, duhet të paraqitet fillimisht tek mjeku i familjes/mjeku i përgjithshëm”,* ndërsa në pikën 13 përcaktohet se: *“Personat e siguruar e përfitojnë recetën me rimbursim vetëm kundrejt zbatimit të sistemit të referimit”.*

Në nenin 10/2/b të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 *“Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”* përcaktohet se: *“2. Paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm hartohen duke përcaktuar: b) listën e barnave të rimbursueshme, si dhe masën e mbulimit të barnave të saj. Struktura e listës së barnave përcaktohet në bazë të listës së barnave themelorë, sipas klasifikimit INN (principit aktiv të barit), të përcaktuar nga OBSH, si dhe në mbulimin e alternativës më të lirë”.*

Referuar Listës së Barnave të Rimbursuara 2016, verifikohet se për barin me principin aktiv: Clopidogrel 75 mg janë të renditura 9 produkte me emra tregtar të ndryshëm dhe emri tregtar Plavix figuron i nënti me çmim patienti më të shtrejtin. Në botimin mbi sqarimet për përdorimin e librit të barnave të rimbursuara 2016, përcaktohet se: *“Sigurimet shëndetësore rimburojnë sipas masës së mbulimit të përcaktuar në VKM nr.391, datë 01.06.2016 alternativën e parë të çdo bari. Alternativat e tjera të renditura gjithmonë pas alternativës së parë u përkasin firmave të tjera farmaceutike, dhe nëse pacientët e siguruar dëshirojnë të marrin njërin prej këtyre alterantivave, duhet të paguajnë diferencën midis çmimit referencë të alternativës së zgjedhur dhe çmimit të rimbursimit nga ana e fondit”.*

Referuar Kartelës Personale nr. 2924 të ankueses M.R, verifikohet se nga data 21.8.2017 deri më datë 28.08.2017 ka qenë e shtruar pranë Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë dhe në dalje është pajisur me recetë me përshkrimin e barnave, ku ndër barnat e tjerë rekomandohej dhe përdorimi i barnave: Plavix (clopidogrel) 75 mg i cili rekomandohej për përdorim minimumi 1 vit.

Referuar Kartelës Personale nr. 2924 të ankueses M.R, verifikohet se në datat 27.09.2017 dhe 02.11.2017 pacientja është pajisur me recetë dhe për barin, Clopidogrel 75 mg nga mjekja e familjes Y.Ç ndërsa në datat 27.12.2017, 27.01.2018 dhe 26.03.2018 pacientja është pajisur dhe për barin, Clopidogrel 75 mg nga mjeku i familjes P.P.

Referuar Regjistrin të Vizitave të Mjekut të Përgjithshëm për të Rritur të Qendrës Shëndetësore nr.3, Korçë të vitit 2017, verifikohet se pacientja M.R është paraqitur për vizita në datat në vijim:

Nr rendor 4054, datë 27.09.2017, nr.4541, datë 27.10.2017, nr.5218 datë 27.12.2017, nr.457, datë 27.01.2018 dhe nr.1098, datë 26.03.2018.

Në vlerësim të dokumenteve të administruara nga palët dhe referuar legjislacionit të sipërcituar e procedurave të kërkuara arrihet në përfundimin se receta e lëshuar nga të dy mjekët e familjes⁴ për pacienten M.R duke përshkruar barin sipas principit aktiv dhe jo sipas emrit tregtar, është kryer sipas procedurave të kërkuara nga legjislacionit në fuqi, ndërkohë që pacientja ka patur mundësi që kundrejt pagesës së diferencës në çmim mund të përfitonte barin alternativ Plavix pasi receta e lëshuar nga mjeku i familjes nuk e ndalonte këtë mundësi. Pra vlerësohet se nuk ka patur veprime, paragjyqime apo trajtim të pabarabartë për shkak të racës së M.R.

Bazuar në dokumentacionin dhe faktet e grumbulluara gjatë hetimit dhe legjislacionit të sipërcituar, vërtetohet se mjekja e familjes V.G nuk ka patur kopetencë për të lëshuar recetë me rimbursim për M.R pasi ankuesja nuk ka qenë paciente e regjistruar pranë mjekes.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se referuar nenit 7, pika 1⁵, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nuk konstatohet trajtim i pafavorshëm i M.R në raport me parashikimet ligjore, pasi veprimet e mjekëve P.P dhe V.G nuk kanë qenë diskriminuese në drejtim të përfitimit të barnave me rimbursim të M.R për shkak të racës.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases M.R, nga ana e P.P dhe V.G, për shkak të racës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(shkaku: raca)
(fusha: te mira dhe sherbime)

⁴ Y.Ç dhe P.P.

⁵ Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.